

RELACIONI TEKNIK I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

**"Ndertim-funksionimi i rrjetit te levizshem
te komunikimeve publike (GSM), per
sherbimin publik telefonik te levizshem
tokesor nepermjet frekuencave E-GSM
900 GSM 1800 MHz dhe UMTS 2100 MHz"**

**Stacioni 1526 – Maja e Vangjelit, Orikum,
Vlore**

Shoqeria Investitore: "ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS" sh.a.

Hartoi raportin:



Qellimi i ketij aktiviteti eshte ndertim-funksionimi i rrjetit te levizshem te komunikimeve publike (GSM), per sherbimin publik telefonik te levizshem tokesor nepermjet frekuencave E-GSM 900 GSM 1800 MHz dhe UMTS 2100 MHz", duke ndertuar nje platform per montimin e nje antene tip "Greenfield" ne Stacionin 1526 – "Maja e Vangjelit", Orikum, Vlore. Eshte nje aktivitet qe ka ndikim jo shume te madh ne mjedis, vetem ne fazen ndertimore te tij. Bazuar ne Ligjin Nr. 10440, date 07.07.2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", Shtoja II, klasifikohet si aktivitet qe i nenshtrohet Procedures Paraprake te Ndikimit ne Mjedis dhe paiset me Vendim per VNM Paraprake. Specifikisht klasifikohet ne: Pika 10. *Prodhime infrastrukturore / a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale;*

Shoqeria Investitore: "ALBANIAN MOBILE COMUNICATIONS" sh.a. (AMC), me NIPT J61814094W, ka lidhur kontrate me shoqerine "Energia B" me NIPT K31714095E, per te projektuar dhe realizuar ngritjen e antenes celulare ne kete stacion. Kontrata eshte lidhur mes dy paleve ne 1 Prill, 2014.

Gjithashtu Shoqeria AMC, ka lidhur kontrate me 28.08.2013, me Z. Viron Leka, zoterues i nje siperfaqe prej 6553 m², prej nga e cila 150 m², merret me qera nga shoqeria per te ndertuar platformen ku do te mbeshtetet antena.

(Bashkangjitur aplikimit, kontratat e siperpermendura)

Vendodhja e aktivitetit

Aktiviteti ne vleresim ndodhet ne Lagjen "Maja e Vangjelit", Orikum, Rrethi Vlore. Trualli eshte toke arre, i dhene me qera per kete lloj aktiviteti. Infrastruktura rrugore eshte ekzistuese dhe nuk eshte e nevojshme hapja e nje rruge te re.

Tipi i antenes: Greenfield (antene qe montohet ne terren te hapur)

Lartesia e antenes: 30 m


Siperfaqja e truallit: 150 m²

Zona Kadastrale: Nr. 2832

Numri i pasurise: 127/4

Indeksi i hartes: K-34-135 (16-C)

Koordinatat: X = 40° 19' 22.4'' dhe Y = 19° 28' 32.1''



3.3. Relacioni teknik

Projektimi i antenes se larte tip kulle duke marre parasysh vendodhjen e saj e cila eshte jashte qendrave te banuara, ne zona te ngritur, maja kodrash, malesh etj.. dhe duke marre parasysh lartesine e tyre, do te jete i tille qe te mos tentoje te fshihet me natyren, por te dal ne pah.

Siperfaqja ku do te zhvillohet ndertimi i antenes eshte 150 m². Tek nje pjese e kesaj siperfaqeje, afersisht 100 m² do te krijohet nje bazament, i cili eshte i perbere nga mure mbajtes betonarme perimetrare, mbushje ne brendesi te ketyre mureve si dhe krijimi i bazamentit te antenes si dhe i bazamentit te elementove suportues.

Pjesa e dukshme e murit perimetral do te jete 1.7 m dhe kuota e siperfaqes perfundimtare te pjeses brenda do te jete sa kuota e pjeses se sipërme te murit.

Per arsye sigurie ky bazament do te rrethohet me rrjete metalike duke fshehur keshtu pajisjet qe do te vendosen brenda saj. Hyrja ne pjesen e brendshme te prones do te behet me ane te dyerve te cilat gjithashtu jane te perbera nga rrjeta metalike.


Lartesia e kullës do te jete afersisht 30 m. Ne baze do te jete 2.3 m dhe do vije duke u ngushtuar me nje kend afersisht 76 grade deri ne lartesine 3.2 m dhe nga kjo kuote deri ne fund te kullës permasat e kullës do te jenc 0.65 m x 0.65 m.

Struktura e kullës do te jete metalike me te gjithë elementet te parapregatitur, duke pershire ketu edhe hapjen e vrimave te nevojshme. Te gjithë keta elemente do te montohen ne vend duke shmangur keshtu ndotjet ne ambientin perreth.

Pjesa e brendshme e antenes do te shfrytezohet per kalimin e kanalave duke i bere keto te fundit te padukshme nga pjesa jashtme e kullës metalike. Ne majen e kullës pervec aparateve te shperndarjes se valeve telefonike do te jete e vendosur nje drite sinjalizuese per mjetet fluturoese si dhe nje rrufesprites.



Lartesia 30 m e antenes si dhe mungesa e objekteve te tjera te larta ne kete zone i jep asaj nje rendesi te vecante dhe fale struktures se saj elegante te krijon idene e nje obelisku duke u bere nje objekt jo vetem funksional por edhe estetik.

Pergatiti
Ark. Rudin DURA




PLANIMETRIA PER OBJEKTIN "ANTENE AMC" 1526 ORIKUMI NEW SH.1:250

PAMJE E OBJEKTIT "ANTENE AMC"



ARKITEKT: RUDIN DURA

***Pamja ballore e antenes**



***Planimetria e antenes**

